

## STATUTI

I SHOQERISE' ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR SE AL SERVICE SH.P.K.

20/01/2017  
Sot, me vendimin e ortakut te vetem te shoqerise u vendos si me poshte:

- **Sergio Bello**, nenshtetas italian, lindur ne San Giuliano Milanese Itali, dt. **14/11/1961** rezident ne Ginosa (TA) Itali, me Pashaporte italiane nr.YA3068448

te hartohet Statuti i nje Shoqerie me Pergjegjesi te Kufizuar, aktiviteti i se ciles do te rregullohet mbi bazen e Legjislacionit Shqiptar aktual, sipas Statutit te Shoqerise bashkangjitur.

### Neni 1 - Emertimi

.1 Emertimi i Shoqerise eshte Se Al Service Sh.p.k. (e cilesuar me poshte si "Shoqeria").

### Neni 2 - Forma Ligjore

- 2.1 Shoqeria SE AL SERVICE Sh.p.k. eshte e themeluar si Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar dhe eshte e rregulluar sipas Statutit te saj si me poshte vijon.
- 2.2 Shoqeria operon sipas Legjislacionit shqiptar aktual.

### Neni 3 -Selia

- 3.1 Shoqeria operon me seli ne adresen: **Rr.Deshmoret e 4 Shkurtit Pall TID shk C Kati II**
- 3.2 Shoqeria mund te kete zyra, dege, perfaqesi dhe agjensi si brenda Shqiperise ashtu edhe jashte shtetit shqiptar.
- 3.3 Ortaku i vetem, mund te vendose, te transferojne dhe/ose te mbyllin, si brenda edhe jashte shtetit shqiptar, dege sekondare, filiale.seli, agjensi, zyra perfaqesimi dhe bashkesi lokale te cdo natyre. >

#### Neni 4 – Objekti

- 4.1 Shoqeria ka objekt social cdo veprim legjitim tregtar qe perfshin, por pa kufizim aktivitetet si me poshte vijojne:
- 4.2 Kontroll, revizionim inventari, e letrave me vlerë të kapitalit, imobiliare, mobiliare, bilanc te enteve publike dhe private; Menaxhimin e te dhenave kompjuterike dhe arkiva; ekspertiza, tregtim i software .  
Aplikime specifike teknike ose jo; analiza, teste, konsulta mbi aparatura elektrike; elektronike.
- 4.3 Inventarizim dhe dhe realizim i arkivimeve te depozitave per dokumentacion historik dhe aktuale per ente publike dhe private;
- 4.4 Katalogimi i letersise dhe mbledhja e dokumentacioneve dokumentare dhe objektet e tyre; Ndertimi dhe / ose tregtimi i hartave te kompjuterizuara;
- 4.5 Menaxhimi i kerkesave financiare te aktiveve per organet publike, menazhim te sherbimeve ne lidhje me listepagesa, paga, TVSH, hartimin dhe kontrollin e pasqyrave financiare dhe te konsoliduara;
- 4.6 Menaxhimi i ndertesave, vendbanimeve dhe tokes.  
Ndertimi, rinovimi dhe mirembajtja e prones; Menaxhimi i prones ne periudhe afatshkurter, afatmesme dhe afatgjate.
- 4.7 Sherbime ne fushen e akomodimit, dhoma ANCHECON, Formula Bed and Breakfast; Sherbime ne fushen e ushqimit dhe rekreacionit; prodhim dhe tregtim te produkteve ushqimore.
- 4.8 Shoqeria mund te kryeje ndonje aktivitet shtese, ndryshe nga sa me siper dhe te perqaset me mundesi financimi nga ente publike, trajnimin e personelit per kryerjen e aktiviteve te kerkimit dhe pjesemarrjes ne tendera.
- 4.9 Shoqeria mund te permbushe te gjitha transaksionet dhe dokumentacionet ne fushen e Real Estate, imobiliare, industriale, financiare e tregtare si instrumente per arritjen e objektivit social qe ka duke perfshire edhe investimet ne rekrutim, perfaqesim ne kompani ekskluzive, shoqata dhe institucione, biznese me qellim dhe objekt te ngjashem social, levrimin e garancive te bashkepunimit reciprok, ne mbeshtetje te legjislacionit, regjistrimin, nenshkrimin ose anulimin e dokumentacioneve ne lidhje me hipotekat, te drejtave dhe interesave reale ne pale te treta.
- 4.10 Shoqeria a angazhohet edhe ne administrimin e instrumentave te borxhit, letrave me vlere, bonove dhe forma te tjera te investimeve.  
Shoqeria do te perfitoje nga keto forma investimi, kontributet per llogari te kapitalit dhe nga interesat,  
duke u mbeshtetur ne legjislacionin vendas persa i perket tatimit dhe autorizimeve te nevojshme per ushtrimin e veprimtarise.
- 4.11 Shoqeria mund te hyje ne forma bashkepunimi, konventa, marreveshje me autoritetet shtetore, rajonale, provinciale e komunale.

Per arritjen e objektit te saj shoqeria mund te lidhe kontrata konsorciumi e te tjera, si dhe te zhvilloje ato aktivite qe jane pjese e kontratave mes enteve publike dhe/ose private.

- 4.12 Çdo aktivitet i shërbimeve për kompanitë ose individët në vend dhe jashtë çdo aktiviteti tjetër 'DHE SHËRBIMEVE QË NUK JANË ndaluar me ligj;

#### **Neni 5 – Kapitali**

- 5.1. Kapitali është 10000 (Dhjetë mijë) leke.  
Kapitali është teresisht i nënshkruar dhe i shpërndarë në këtë mënyrë:

**Sergio Bello** 100%( 10.000 – dhjetë mijë)

#### **Neni 6 – Transferimi i kuotave**

- 6.1 Kuotat e kapitalit do të jenë të transferueshme tek palë të treta sipas rregullave të përcaktuara në Statut.

#### **Neni 7 – Administratores**

- 7.1 Shoqëria mund të jetë e administruar nga një apo me shumë Administratore me zotimin për të vepruar individualisht ose bashkërisht, sipas mënyrës së përcaktuar që në emerim.
- 7.2 Administratori është në fuqi deri në momentin e dorëheqjes ose shkarkimit me vendim të Ortakut të vetëm për një periudhë 3 (tre) vjeçare me të drejtë rimerimi.
- 7.3 Fundi i mandatit të Administratorit në përfundim të periudhës së detyrës bëhet i vlefshëm nga momenti i rivendosjes së organit të ri administrativ.
- 7.4 Administratorit i takon detyra e përfaqësimit të Shoqërisë përballë palëve të treta si edhe përgjegjësia e gjyqimit dhe zgjidhjes së çështjeve me karakter me të gjere si edhe rasteve të jashtëzakonshme për administrimin e Shoqërisë që mund të shfaqen mbi bazën e parashikuar në *Nenin 95 të Ligjit nr. 9901 dt 14.04.2008 Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare* dhe në çdo rast brenda kufizimeve të përcaktuara në aktin e themelimit dhe/ose statutit të Shoqërisë.
- 7.5 Administratori mund të vendosë Përfaqësues Ligjorë për akte të vecanta apo kategori aktesh dhe veprimesh.
- 7.6 Detyra e administratorit nënkuptohet e lire, përveç kur me vendim të Ortakut të vetëm vendoset një zgjidhje dhe përcaktohet një shpërblim i përgjithshëm.  
Administratorit i takon rimbursimi i shpenzimeve të kryera për llogari të zyrës së tyre.
- 7.7 Me këtë akt themelimi vendoset si Administrator i Shoqërisë:
- 7.8 Znj.Gerta Minga, lindur në Tiranë me 01/02/1987 dhe banuese në Tiranë me nr
- 7.9 pashaportë I75201054L

ORTAKE

**Sergio Bello**

**Perkthyes: Gerta Minga**

